



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:032034
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05341005

Ac.nr.3115/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.B.H., nga fshati Sh....., Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. G.K., nga Suhareka, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KESCO Sh. A. / Distrikti Prizren, Rr.’’S..... Rr....’’, nr.XX, lidhur me padinë për shlyerjen e ngarkesës në emër të rikthimit të humbjeve, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.734/2020 të datës 01.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KESCO Sh. A. / Distrikti Prizren, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.734/2020 të datës 01.04.2021, dhe çështja kthehet në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.734/2020 të datës 01.04.2021, në dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit S.B.H., nga fshati Sh....., Komuna e Suharekës. Në pikën një e ka detyruar të paditurën Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a – KESCO Sh. A. Distrikti Prizren, që ta bëjë shlyerjen e ngarkesës në emër të rikthimit të humbjeve për periudhën 12 mujore në vlerë prej 2.210,00 €, sipas faturës DPZ XX HP XXX në njehsorin elektrik DPZ XX XX XX me numër të njehsorit XX XX XX e regjistruar në emër të paditësit S.B.H., Në pikën dy është obliguar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore paditësit t’ia kompensoje shumën prej 270 €. Në pikën tre e ka detyruar të paditurën që të veprojë si në piken një dhe dy

të këtij dispozitivi, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës, aktgjykimin e atakuar ta anuloj si kundërligjor dhe ta hedhë poshtë padinë e paditësit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me përgjigje në ankesë, ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi ankimor të vërtetohet, po ashtu ka propozuar të obligohet e paditura ti bartë shpenzimet e përgjigjes në ankesë në shumë prej 104.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 02.11.2018 ka ushtruar padi, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a – KESCO Sh. A. Distrikti Prizren, që ta bëjë shlyerjen e ngarkesës në emër të rikthimit të humbjeve për periudhën 12 mujore në vlerë prej 2.210,00 €.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka administruar provat e çështjes ka nxjerr aktgjykimin me të cilin e ka pranuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendos si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhim i një procesi të parregullt gjyqësor për çka epilogu i dhënë me aktgjykimin e atakuar ka rezultuar si i paligjshëm, sepse i njëjti është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parg.1 pika(n) të LPK-së, kjo ngase aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos pjesa e dispozitivit të tij është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete ose me arsyet që përmban, ndaj për shkak të metave të tilla është dashur që i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim në shkallë të parë.

Gjykata e Apelit, më rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paditurit në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së aktgjykimit të atakuar, ka gjetur se i njëjti është nxjerr me te meta të cilat e bëjnë të parregullt dhe paligjshëm mënyrën e vendosjes sipas dispozitivit të aktgjykimit të atakuar e të cilat mund të evitohen vetëm me rishqyrtimin e çështjes në shkallë të parë.

Kolegji duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar ka gjetur se pretendimet ankimore të të paditurit janë të bazuara parasëgjithash për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është i

kuptueshëm dhe si i tillë i paegzaminueshëm në kuptim të përshtatshmërisë së tij për përmbarim. Pra, gjykata, në këtë çështje juridiko-civile në bazë të thënieve në padinë e paditësit ka proceduar pa marrë për bazë Ligjin Nr.05/L-085 Për Energjinë Elektrike, i cili në nenin 55 Faturimi dhe pagesat, ka përcaktuar kushtet e përgjithshme të konsumatorit i cili është shfrytëzues i energjisë elektrike, e duke qenë se objekt kontesti është shlyerja e ngarkesës në emër të rikthimit të humbjeve, është dashtë që të vërtetohet nëse paditësi ka ndjekur hapat ligjor sipas Vendimit të datës 09.10.2018, lëshuar nga Departamenti për konsumator në Distrikti në Prizren i Kompanisë KESCO Sh. A., sepse në bazë të Ligjit Nr. 05/L-084 Për Rregullatorin e Energjisë, me nenin 17 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 është paraparë që: *“Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara dhe nga të licencuarit kundër të licencuarve të tjerë, në lidhje me performancën”*. Ndërsa me nenin 3 është përcaktuar se :*“Rregullatori do të nxjerr vendim brenda dy (2) muajsh nga pranimi i ankesës”*, nga del se për çdo ankesë të parashtruar nga konsumatori i energjisë elektrike Zyra e rregullatorit të energjisë elektrike është e detyruar që të nxjerrë vendim dhe të vendos për ankesë. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala paditëse ka mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente në Kosovë, në pajtim me nenin 43 të këtij ligji dhe me Ligjin mbi Procedurën Administrative”.

Rrjedhimisht Gjykata ankimore, vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, edhe pse është kujdesur për kompetencën e saj lëndore, në rastin konkret, është dashtë që të vërtetohet se paditësi a ka ndërmarrë hapat ligjor administrativ pranë të paditurës, e pastaj të vlerësoj thëniet në padi dhe kërkesëpadi se çështja e ngritur në padi a përbën çështje kontestimore apo se nuk është kompetente ajo gjykatë, veçse ndonjë organ tjetër shtetëror, ashtu siç është e përcaktuar me dispozitën e nenit 18 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkeljet e cekura si në arsyetim të këtij aktvendimi, për eliminimin e të cilave, gjykata e shkallës së parë duhet të ndërmarrë veprime të caktuara, duke u kujdesur njëkohësisht që të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale në atë mënyrë që të evitohet paraprakisht mangësitë procedurale- gjegjësisht të evitohet prezumimet procedurale negative që ndërliken me rregullsinë e padisë, gjykata e shkallës së parë përveç se ka obligim që të vërtetohet drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, ajo duhet të kujdeset për zbatimin e saktë të së drejtës materiale. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të vendimit t’i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga neni 160 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 parag.1, pika (c) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3115/2021, me datë 06.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v.